



ALEANCA LGBTI

Termet e Referencës (TOR) për Auditues të Jashtëm

Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI+ është një organizatë jo-qeveritare shqiptare që parashikon një shoqëri të lire, të hapur, dhe të barabartë për të gjithë qytetarët pavarësisht orientimit të tyre seksual apo identitetit gjinorë.

Aleanca ka për qëllim fuqizimin e komunitetit LGBTI+, mbrojtjen e të drejtave të tij dhe luftën kundër diskriminimit të bazuar tek orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Aleanca nisi aktivitetet e saj në mars të vitit 2009, kur një grup vullnetarësh LGBT filluan punën mbi hartimin e programeve dhe aktiviteteve për komunitetin, dhe u regjistrua si organizatë jo-qeveritare në nëntor 2009.

Objektivi i Auditimit:

1. Auditimi i pasqyrave financiare të Aleancës në mënyrë që audituesit të japin një opinion të pavarur profesional mbi pozicionin financiar të Aleancës dhe të sigurohen që fondet e përdorura për aktivitetet e saj janë shpenzuar për qëllimet e synuara.
2. Auditimi i librave kontabël të Aleancës të ciët ofrojnë bazën për përgatitjen e pasqyrave financiare. Librat e llogarive të mbajtura sipas kërkesave ligjore të përditësuar nga Aleanca dhe që përmbajnë kontrole të brendshme adekuate si dhe dokumentacionin mbështetës për transaksionet.

Fushëveprimi i Auditimit:

1. Auditimi do të kryhet në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit dhe do të përfshijë teste dhe procedura verifikimi sipas nevojës.
2. Të verifikohet që të gjitha fondet janë përdorur sipas rregullave dhe rregulloreve të organizatës dhe vetëm për qëllimet e dhëna.
3. Të verifikohet që mallrat, punët dhe shërbimet e financuara janë prokuruar në përputhje me rregullat dhe procedurat e organizatës.
4. Dokumentacioni mbështetës, të dhënat dhe librat kontabël për aktivitetet janë mbajtur si duhet, dhe ekziston një lidhje e qartë ndërmjet librave kontabël dhe pasqyrave financiare të paraqitura.
5. Pasqyrat financiare të përgatitura nga menaxhmenti i Aleancës janë në përputhje me standardet kontabël në fuqi dhe japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar dhe transaksioneve.
6. Të vlerësohet përshtatshmëria dhe efektiviteti i sistemit të kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm për monitorimin e shpenzimeve dhe transaksioneve financiare.
7. Të jepet një opinion mbi arsyeshmërinë e pasqyrave financiare në të gjitha aspektet materiale.
8. Të përfshihet një opinion mbi përputhshmërinë me procedurat për të siguruar zbulimin e anomalive materiale për shkak të gabimeve ose mashtrimeve.
9. Auditori duhet të kontrollojë nëse raporti vjetor është në përputhje me kërkesat ligjore.
10. Takim hyrës dhe dalës me Drejtorin Ekzekutiv të Aleancës.



ALEANCA LGBTI

11. Auditorët do të përgatisin një Letër Menaxhmenti, që do të përfshijë:

- a. Komente mbi të dhënat kontabël, procedurat, sistemet dhe kontrollet e shqyrtuara.
- b. Identifikimin e mangësive në sisteme dhe kontrolle dhe rekomandime për përmirësime.
- c. Çështje me ndikim të mundshëm në qëndrueshmërinë e organizatës.
- d. Çështje të tjera të rëndësishme për Drejtorin Ekzekutiv.

Kohëzgjatja e Auditimit:

Auditimi duhet të përfundojë brenda tre javësh nga data e fillimit.

Produktet:

1. Pas përfundimit të auditimit, auditorët do t'ia dorëzojnë Drejtorit Ekzekutiv katër (4) kopje origjinale të Raportit të Auditimit bashkë me pasqyrat financiare dhe raportet.
2. Letra e Menaxhimit në përputhje me qëllimin e punës.

Kualifikimi i Firmës së Auditimit:

Firmat e auditimit me bazë në Shqipëri kanë të drejtë të aplikojnë.

Në e përzgjedhjes do të merren parasysh vetëm firmat e licensuara të auditimit ose auditues të licensuar.

Buxheti për këtë thirrje: 5000 EURO (bruto).

Afati i Fundit:

Afati i fundit për pranimin e ofertave është 30 Nëntor.

Ju lutemi dërgoni ofertat bashkë me një kopje të licencës në adresën e mëposhtme të emailit: aleanca.al@gmail.com